




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-113/2013
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	22.01.2013
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.12.2012, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-2431/12, për zyrtarin e lartë z.Gani Sylaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Post Telekomin e Kosovës (PTK), për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se i ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit, dhe nuk ushtron më funksion udhëheqës në kompani private.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-2431/12, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Gani Sylaj, anëtar i bordit të drejtorëve në Post Telekomin e Kosovës(PTK).

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si anëtar i bordit të drejtorëve në Post Telekomin e Kosovës, ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), si person i autorizuar dhe aksionar në biznesin N.T.P "Dreni" sh.p.k, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 08.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e

parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Gani Sylaj, ka komunikuar me zyrtarët e Agjencisë dhe e ka konfirmuar se e ka marr shkresën njoftuese, dhe dëshiron të njoftohet me detal për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Me datën 15.08.2012, z. Gani Sylaj, ka ardhur në zyrat e Agjencisë kundër Korrupsionit për të biseduar, lidhur me njoftimin që i kemi bërë për fillimin e hetimeve për konflikt të interesit.

Gjatë takimit e kemi njoftuar z. Sylaj, se për cilën situatë bëhet fjale, ndërsa ai është shprehur i gatshëm për bashkëpunim, por na ka njoftuar se për çështjen që ka të bëjë lidhur me angazhimin e tij në biznes privatë situata reale, është se ai ka qenë i regjistruar në ARBK, si përsôn i autorizuar dhe drejtor i bordit të asaj kompanie, mirëpo në realitet kompania nuk është funksionale dhe nuk kryen asnjë aktivitet, por është zotuar se do të veproj si pas kërkesës dhe këshillës së Agjencisë, për ta shmangur çfarë do suate të konfliktit të interesit brenda afatit ligjore.

Zyrtari i lartë z. Gani Sylaj, anëtar i bordit të drejtorëve në Post Telekomini e Kosovës, gjatë procesit për shmangien e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit ka qenë kooperativë dhe bashkëpunues, për të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë lidhur me procedurat e ka njoftuar Agjencinë.

z. Gani Sylaj, me datën 21.12.2012, e ka njoftuar Agjencinë se pas shumë problemeve që ka pasur për ti mbledhë anëtarët e bordit të drejtorëve të kompanisë, N.T.P “Dreni” sh.p.k, e cila nuk është aktive, ka marr vendim që të tërhiqet nga pozita e drejtorit dhe personit të autorizuar në kompaninë N.T.P “Dreni” sh.p.k, dhe ka mbetur vetëm aksionare si dhe ka bërë ndryshimet e kërkuara pranë ARBK-së, dhe është në procedurë të shuarjes së këtij biznesi.

Zyrtari i lartë z. Gani Sylaj, anëtar i bordit të drejtorëve në Post Telekomini e Kosovës, nuk gjendet me në situatën e përshkruar si konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pasi që nuk ushtron me pozitën ku ishte drejtor i bordit dhe përsôn i autorizuar në biznesin N.T.P “Dreni” sh.p.k.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si anëtar i bordit të drejtorëve në Post Telekomini e Kosovës, dhe përsôn i autorizuar në kompani private.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni,  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

